



Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren
Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR						
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	Viti akademik	2021/2022	
LËNDA		Stilistikë e gjuhës shqipe				
Viti	IV	Statusi i lëndës	obligative	Kodi	ECTS kredi	4
Semestri	VIII					
Javët mësimore	15	Orët mësimore	Ligjërata		Ushtrime	
			2	1		
Metodologjia e mësimimit	Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentin pjesëmarrës aktiv jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjërata					
Konsultime						
Mësimdhënësi	Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj	e-mail	xhafer.beqiraj@uni-prizren.com			
		Tel.	+383 (0) 44 950 - 369			
Asistenti		e-mail				
		Tel.				

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë drejt se Stilistika është njëra nga lëndët e cila ka lidhje të ngushtë me lëndët e tjera në kuadrin e gjuhësisë dhe se mësimi i kësaj lënde i bën të zotë studentët të dinë për stilin, stilemat e përftesat, për organizmin stilistik, stilistikën funksionale, koherencën midis pjesëve të tekstit, paragrafëve dhe të fjalisë, për organizimin e tekstit. -Të ngrenë nivelin e përgjithshëm mbi përdorimin e gjuhës sipas normës gjuhësore dhe stilistike. -Të identifikojnë, të kuptojnë dhe të zbatojnë konceptet dhe teoritë nga fusha e stilistikës. -Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre. -Të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e stilistikës. -Të aftësohen për punë kërkimore-hulumtuese individuale e grupe. -Të zhvillojnë aftësitë për të gjykuar, krahasuar, analizuar, sintetizuar etj. 	<p>Pikësynimi kryesor i lëndës është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të kuptojnë se Stilistika është lëndë e pandashme nga degët kryesore të gjuhësisë, sh së gjurimit akademik dhe se shkrimi i një teksti nënkupton një dije të mirëfilltë paraprake mbi gjuhën, sistemin dhe përdorimin e saj. -Ta përvetësojnë mësimin mbi stilistikën, organizimin stilistik, stilistikën funksionale, ngjyrimet stilistike. -T'i përvetësojnë teknikat e shkrimit dhe t'i dallojnë mirë ato, si: <ul style="list-style-type: none"> -Analizimi/përzgjedhja e temës; Kërkimi/mbledhja e materialit: Plani i përgjithshëm: grupimi dhe kategorizimi i informatave; Të shkruarit e tekstit - sfondi, ligjërimi/ diskursi, stili dhe diskursi, përdorimi i gjuhës; Rishikimi i tekstit - redaktimi autorial; Struktura e tekstit, struktura e paragrafit, llojet e paragrafëve (sipas karakterit), paragrafi përshkruar, paragrafi shpjegues, paragrafi retorik-bindës; -Të aftësohen të dallojnë llojet e stileve; - Të fitojnë njohuri dhe të përvetësojnë normën stilistike; -Të kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të teknikave të shkrimit

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
<p>ECTS-sistemi europian i transferimit dhe procesi i akumulimit të kredive, është një sistem i orientuar kah studentit dhe paraqet vleftën e ngarkesës së tij për të arritur objektivat e një lënde (kursi) ose programi të caktuar të studimit.</p> <p>Ngarkesa e studentit sipas ECTS bazohet në kohën që nevojitet për t'i kompletuar aktivitetet e planifikuara rreth një lënde (kursi), siç janë: pjesëmarrja në ligjërata, aktiviteti dhe pjesëmarrja në ushtrime, puna në terren, përgatitja e projekteve dhe plankonspekteve, prezantimet dhe mbajtjet e orëve, punime seminarike, punë konsultative me mentorin, puna e pavarur në bibliotekë ose në shtëpi, përgatitja përfundimtare e provimit, koha e kaluar në provim dhe parametra të tjerë.</p>			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Tabela, shkumësi, laptopi, projektori etj.			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
	91% - 100%	10 (dhjete)	
	81% - 90%	9 (nëntë)	
	71% - 80%	8 (tetë)	
	61% - 70%	7 (shtatë)	
	51% - 60%	6 (gjashtë)	
	50%	5 (pesë)	
Obligimet e studentit:			
Ligjërata	Ushtrime		
<p>Studentët kanë për detyrë të ndjekin rregullisht ligjëratat. Në mënyrë ndërvepruese të marrin pjesë në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe t'i kryejnë të gjitha angazhimet që i jep mësimdhënësi.</p>	<p>Studentët kanë për detyrë të marrin pjesë aktive në orët e ushtrimeve. Për çdo paqartësi që kanë me materien e lëndës mësimore, të konsultohen me mësimdhënësin. Gjatë semestrit të bëjnë një punim seminarik, me parapëlqim që ai të prezantohet me Power Point në klasë, të hyjnë në dy testet (gjysmësemestral) dhe së fundmi t'i nënshtrohen provimit përfundimtar.</p>		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata:	2	15	30
Ushtrime:	1	15 javë	15
Detyra kursi	1	10 Javë	10
Punime seminarike:	2	2 javë	4
Koha e studimit të pavarur në biblioteka:	1	10 javë	10
Projekte, prezantim:	1	6 javë	6
Përgatitja e provimit përfundimtar	1	15	15
Konsultime	1	10	10

Vërejtje: Po qe se vlefte e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezulton se për ta përgatitur provimin e lëndës së <i>Stilistikës së gjuhës shqipe</i> , studentit i duhen 100 orë punë. Kjo del edhe kur 100 orë pjesëtohen me 25, rezulton se lënda ka vleftë prej 4 kredish.	Ngarkesa totale:	100
--	-------------------------	-----

Java	Ligjërata	Orët	Ushtrime	Orët
1.	Tema Objekti i stilistikës Retorika dhe stilistika	2	Tema Ushtrime – retorika dhe stilistika	1
2.	Historiku i zhvillimit të stilistikës	2	Ushtrime për historikun	1
3.	Njësitë dhe nocionet fillestare të stilistikës . - Stilema, përftesa, ngjyrimet stilistike, informacioni plotësues, norma stilistike, Burimet e shprehësisë	2	Ushtrime për nocionet: stilemë, përftesë, normë stilistike etj.	1
4.	Organizimi stilistik -Tipat e ligjërimit, Toni i ligjërimit, Kategoritë e teksteve, Ndërthurja dhe zgjedhja, rimarrja.	2	Ushtrime për stilin, tipat e ligjërimit etj.	1
5.	Fonostilistika	2	Ushtrime për fonostilistikën përmes analizës së teksteve	1
6.	Morfostilistika	2	Ushtrime për morfostilistikën, analizë teksti	1
7.	Sintaksostilistika	2	Ushtrime për sintaksostilistikën përmes analizës së teksteve	1
8.	Leksikostilistika	2	Ushtrime për leksikostilistikën përmes analizës së teksteve letrare	1
9.	Test gjysmësemestral I	2	Përgatitje për test	1

10.	Semantostilistika	2	Ushtrime për semantostilistikën përmes analizës së teksteve letrare	1
11.	Ligjërimet i folur	2	Ushtrime për ligjërimin e folur	1
12.	Ligjërimi i shkruar	2	Ushtrime për ligjërimin e shkruar	1
13.	Stili i veprimtarisë shtetërore e administrative Stili i veprimtarisë shoqërore e politike	2	Ushtrime për stilet	1
14.	Stilistika e letërsisë artistike (Gjuha e letërsisë artistike)	2	Ushtrime për stilin artistik	1
15.	Test gjysmësemestral II	2	Përgatitje për test	1

LITERATURA

Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2012.

Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, 2017.

Hasan Mujaj, *Stilistika gjuhësore në epikën kreshnike*, Faik Konica, Prishtinë, 2003.

VËREJTJE

Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve e vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe Këshilli Mësimor.

Pritet që secili student të vijë me kohë.

Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e nevojshme (e domosdoshme).

Mungesat në ligjëratat dhe ushtrime rezultojnë me zbritjen e notës përfundimtare. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shpëtojnë telefonat mobilë gjatë ligjëratave.